

## **INFORMACION I DETAJUAR, BURSË NË PARLAMENTIN GJERMAN**

*Bursa Ndërkombëtare Parlamentare e Bundestagu-t Gjerman (IPS) ju mundëson ndjekjen nga afër të aktivitetit të përditshëm parlamentar gjerman përgjatë pesë muajve. Gjatë kësaj kohe do të punoni në zyrën e një deputeti si dhe keni mundësinë të ndiqni leksione pranë universiteteve të Berlinit. Bundestagu Gjerman së bashku me Universitetin e Lirë të Berlinit, Universitetin Humboldt të Berlinit dhe Universitetin Teknik të Berlinit jep çdo vit afërsisht 120 bursa për të diplomuarit e rinj nga 42 vende. Programi zgjat çdo vit nga 1 Marsi deri më 31 Korrik.*

*Nëse keni njohuri shumë të mira në gjuhën gjermane, keni përmbyllur studimet ose jeni pak përpara përmbylljes, jeni më të rinj se 30 vjeç si dhe keni shtetësinë shqiptare, ne do të gëzoheshim nëse do të aplikoni për këtë bursë deri më 31 Korrik [2019](#).*

*Për informacione të mëtejshme rreth programit shihni këtu: <http://www.bundestag.de/ips>*